



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Njësia e Prokurimit**

Gjakovë, datë 26.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “MetBat” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “**Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat të skaduar**”, Nr. i prokurimit- 632-23-6728-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-090 -221, nxjerr:

**V E N D I M**

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: “MetBat” SH.P.K ,e dt.17.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat të skaduar**”, Nr. i prokurimit- 632-23-6728-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-090 -221, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 04.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË** me përmirësimet e publikuara me datë: 21.07.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y c i m**

Operatori Ekonomik “MetBat” SH.P.K. me dt.24.07.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Asgjësimi i mbetjeve medicinale dhe barnave me afat të skaduar**”, Nr. i prokurimit- 632-23-6728-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-090 -221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 26.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues me përmirësimet e dosjes së tenderit, të publikuara me dt.21.07.2023, është kërkuar që Operatorët ekonomik të ketë licencë për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve mjekësore në përputhje me Ligjin për mbeturina 04/L - 060 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin 08/071 – çka nënkupton se Operatorët ekonomik mund të prezantojnë licenc për menaxhimin e mbeturinave ose leje përkatëse mjedisore., siç është bërë ndryshimi në ligjin 08/071, I cili ligj është cituar edhe në kërkesat e bëra me dt.21.07.2023.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

**Faton Gutaj**  
  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

